



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**V E N D I M**

**Nr. 384, datë 3.12.2015**

**Mbi**

**“Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft.nga shoqëria Messer Hungarogaz Kft.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |                            |             |
|----------------------------|-------------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar     |
| ▪ Znj. Servete Gruda       | Zv. Kryetar |
| ▪ Z. Koço Broka            | Anëtar      |
| ▪ Znj. Iva Zajmi           | Anëtar      |
| ▪ Z. Eduard Ypi            | Anëtar      |

Në mbledhjen e tij të datës 3.12.2015, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft.nga shoqëria Messer Hungarogaz Kft.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Messer Hungarogaz Kft. / Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft. dhe relacionit shoqëruar të Sekretarit të Përgjithshëm,

**V Ë R E N S E :**

**1. Transaksioni dhe përqendrimi**

Përqendrimi realizohet me anë të “Marrëveshjes për transferimin e kuotave” të datës 15 Shtator 2015, e lidhur ndërmjet palëve shoqëria Air Liquide Eastern Europe S.A (në cilësinë e aksionarit shitës) dhe Messer Hungarogaz Kft. (në cilësinë e blerësit), me objekt transferimin e 100% të kuotave të shoqërisë Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft (në cilësinë e target-it) të lira nga çdo barrë.

Përqëndrimi nuk prek në mënyrë të drejtpërdrejtë tregun e brendshëm të produktit sa i përket gazit industrial, por njoftimi i përqendrimit është bërë për shkak të xhirove që realizon Grupi Messer në Shqipëri me anë të degës së tij Messer Albagaz Sh.p.k.

Transaksioni i përqendrimit me anë të të cilit shoqëria Messer Hungarogaz Kft. përfton kontrollin e vetëm dhe ekskluziv të shoqërisë Air Liquide Hungari Ipari Gaztermelo Kft., përbën një ndryshim kontrolli mbi baza të qëndrueshme dhe për pasojë përbën një përqendrim në bazë të nenit 10.1.b) të Ligjit nr. 9121, datë 27.8.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) dhe plotëson kriteret e xhiros në tregun ndërkombëtar dhe tregun e brendshëm.

## 2. Palët në transaksion

- ✚ **MESSER HUNGAROGAZ Kft: (“Messer HU”)** në cilësinë e **blerësit**, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit Hungarez, me seli në adresën: H\_1044 Budapest, Vatici ut 117, Hungari. Fusha e veprimtarisë së shoqërisë është kryesisht prodhim dhe shpërndarje e gazit industrial, etj.

Shoqëria është prezent në Shqipëri me anë të shoqërisë **Messer Albagaz Sh.p.k.** që prej vitit 2011.

- ✚ **AIR LIQUIDE HUNGARY IPARI GAZTERMELO Kft. (“Air Liquide”)**, në cilësinë e **shoqërisë target**, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit hungarez, me seli në adresën: H-1013 Budapest, Krizstina krt. 39/b.2, Hungari. Objekti i aktivitetit të ndërmarrjes është: (i) krijimi dhe operimi i një apo më shumë njësisive të prodhimit, prodhimi dhe / ose importimi i gazit industrial ose gazit të ajrit në formë të lëngshme apo të gaztë, etj.

Shoqëria nuk është prezente në Shqipëri.

## 3. Xhiro për vitin 2014

### 3.1 Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është **XXXXX ALL**

- Messer Group: XXXX € = XXXX ALL.
- Messer Hungarogaz Kft: XXXX HUF = XXXX ALL
- Air Liquide Group: XXXX € = XXXX ALL
- Air Liquide Hungary Ipazi – Gaztermelo Kft: XXXX HUF = XXXX ALL

### 3.2 Xhiro totale në **tregun e brendshëm** është **XXXX ALL**:

- Messer Albagaz shpk : XXXX ALL.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, gërma b) të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

## 4 Tregu përkatës

**4.1 Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe sa më sipër, treg përkatës në analizën e përqendrimit të ndodhur është konsideruar ‘gazet industriale’.

**4.2 Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

#### **4.2 Efektet në treg pas përqendrimit.**

Realizimi i këtij transaksioni prek vetëm tregun hungarez. Struktura e tregut të gazeve industrialë në vendin tonë do të mbetet e njëjtë si para transaksionit. Air Liquid Hu nuk ushtron aktivitet në tregun shqiptar dhe si rrjedhojë nuk kemi mbivendosje të aktiviteti të palëve në tregun përkatës së produktit. Pjesët e tregut dhe fuqia e Messer Albagaz pas realizimit të përqendrimit do të mbetet e njëjtë.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye propozojmë t’i kërkon Komisionit autorizimin e këtij përqendrimi në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft. nga shoqëria Messer Hungarogaz Kft.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit, pasi të bëhen pagesat që parashikon Rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**  
(\_\_\_\_\_)  
**Zv. Kryetar**

**Koço BROKA**  
(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Eduard YPI**  
(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**